REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Përshëndetje.

Prezent janë të gjithë anëtarët e Këshillit.

Pa humbur kohë fillojmë me rendin e ditës nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi çështjet që kemi parashikuar për të shqyrtuar sot.

Kalojmë tek çështja e parë, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Do relatohet nga zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Pa humbur kohë paraqes relacionin përkatës që shoqëron projektvendimin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës "Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe referuar Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj ndaj magjistratëve, profili gjyqtar.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit, me pëlqimin e tij, në institucionet brenda sistemit të drejtësisë, si dhe organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu në dispozitat e këtij ligji, konkretisht në nenet 54 - 58, përcaktohet edhe procedura që duhet të ndjekë Këshilli, ashtu dhe institucionet e tjera në të cilat magjistrati mund të komandohet, në këto raste.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor u depozitua shkresa nr. 1028 prot., datë 28.12.2022, e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, përmes të cilës Këshillit iu kërkua nisja e procedurave të komandimit sipas neneve 53 dhe 54 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e pedagogut të brendshëm janë përcaktuar në nenin 264 të ligjit nr.115/2016, si dhe në Aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Kriteret për përzgjedhjen e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm janë të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Ligji parashikon se pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e: juristëve më të

shquar; me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse universitare apo në Shkollën e Magjistraturës mbi 10 vjet.

Për lëndët kryesore mund të aktivizohen edhe pedagogë të jashtëm, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara për pedagogët e brendshëm. Nëse kandidati për pedagog i jashtëm vjen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve në detyrë, të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të plotësojnë kriteret e të qenit 10 vjet gjyqtar ose prokuror dhe me eksperiencë mësimdhënie universitare apo në Shkollën e Magjistraturës mbi 5 vjet. Për lëndë specifike aktivizohen specialistët e atyre fushave.

Përveç kritereve ligjore në këtë Aneks janë parashikuar edhe kritere shtesë, të rëndësishme për përzgjedhjen e të gjithë pedagogëve, trajnerëve/ekspertëve, të cilët duhet të konkurrojnë në mënyrë kumulative me kriteret ligjore të cilat vlerësohen nga Shkolla e Magjistraturës.

Shkolla e Magjistraturës në njoftimin e publikuar në faqen e saj zyrtare elektronike, sipas vendimit nr. 39, datë 28.12.2022 të Këshillit Drejtues, me të cilin ka shpallur 1 vend vakant për pozicionin Pedagog i Brendshëm, ka përfshirë edhe kritere specifike si më poshtë:

"A. Për kujtesë, kandidati për pedagog të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës duhet të plotësojë kriteret si vijon:

1. Të jetë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë;
2. Të ketë kaluar Vetting-un;
3. Të ketë mbaruar studimet në Shkollën e Magjistraturës;
4. Të jetë vlerësuar minimalisht "shumë mirë" nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
5. Të ketë marrë leje nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
6. Të ketë bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës në trajnimin vazhdues;
7. Të ketë qenë ekspert/lehtësues në trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;
8. Të jetë njohës i mirë i një ose disa gjuhëve të huaja.

B. Afati i komandimit është për një periudhë 2, në opsion përtëritje deri në 4 vjet."

II. Vlerësimi i Komisionit

Për sa më lart, Komisioni vlerëson se kërkesa e datës 28.12.2022 të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës për pozicionin pedagog i brendshëm përfshihet në sferën e pozicioneve të institucioneve të tjetra brenda sistemit të drejtësisë, në kuptim të pikës 2 të Nenit 53 të ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet se: "Institucioni në të cilin magjistrati komandohet", për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit si dhe organizatat ndërkombëtare."

Ndaj sa më sipër, mbështetur në shkronjën "ë", pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën "a", pika 2, të nenit 61, në shkronjën "d" të nenit 86, në shkronjë "b", pika 1, të nenit 97, nenet 264 dhe 265 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbi kërkesën e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës sipas Shkresës nr. 1028 prot., datë 28.12.2022, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projektvendimin "Për hapjen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit".

Komisioni vlerëson të shpallet ky pozicion për komandim duke mbajtur në vëmendje situatën aktuale në gjykata në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku struktura organizative është 408 gjyqtarë; organika në fakt, 317 gjyqtarë; efektivisht në detyrë ushtrojnë detyrën 228 gjyqtarë; si edhe mbajtur në konsideratë faktin se në vitin 2023 pritet të përfundojnë studimet në Shkollën e Magjistraturës 40 kandidatë për magjistratë profili gjyqtar.

III. Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 2 krerë, të cilët trajtojnë në brendësi çështjet: i) shpalljes së kërkesave për kandidatura dhe ii) kohëzgjatjes, kriteret dhe procedurën e komandimit të gjyqtarit.

Kreu I i projektvendimit, bën fjalë për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

Në pikën 1 përcaktohet hapja e procedurës së komandimit të gjyqtarit.

Në pikën 2 përcaktohet shpallja e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm.

Në pikën 3 përcaktohet se afati i paraqitjes së kërkesave për komandim të jetë dy javë nga shpallja e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose një datë fikse e përcaktuar të paktën 15 ditë nga mbledhja e Këshillit që do të shqyrtojë këtë projektvendim. Është kërkesë opsionale. Ne propozojmë datën 13.02.2023 që përfshin afatin e mbi dy javëve si datë e fundit ku kandidatët paraqesin kërkesën.

Në pikën 4 përcaktohet se bashkë me kërkesën për komandim, kandidati duhet të dorëzojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe dokumentet që provojnë plotësimin e kritereve të komandimit.

Në Kreun II të projektvendimit, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit të gjyqtarit.

Sipas pikës 1 të këtij Kreu, kohëzgjatja e komandimit, në këtë pozicion të shpallur, përcaktohet të jetë 2 vjet me të drejtë ripërsëritjeje. Ky afat është brenda limitit maksimal të përcaktuar nga ligji, konkretisht: pika 5, e nenit 53, të Ligjit nr.96/2016, si edhe pika 2 e nenit 265 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe në përputhje me kërkesat specifike të institucionit.

Në pikën 2 të këtij Kreu, përcaktohen rastet e përfundimit të komandimit para afatit, në pozicionin e shpallur, konkretisht kur: a) kërkohet nga vetë gjyqtari për shkaqe të justifikuara (përderisa komandimi është me pëlqim); b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit, pra kur verifikohet kushti kryesor i komandimit; c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore; ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen; d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra.

Më tej, në pikën 3 të këtij Kreu, jepen kushtet e komandimit, në pozicionin e shpallur, të përcaktuara nga neni 53 e vijues të Ligjit nr. 96/2016, konkretisht: a)

komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; b) kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit dhe ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës; d) kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Në pikën 4 të Kreut II, jepen kriteret specifike të komandimit për pozicionin "Pedagog i Brendshëm", pranë Shkollës së Magjistraturës, sikurse janë ato ligjore të përcaktuar nga neni 264 i ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe Aneksi 11 i Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë:

a) Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënieje si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi dhjetë vjet; ose

b) Kandidati, që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të ketë eksperiencë mbi dhjetë vjet si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi pesë vjet.

Në pikën 5 parashikohen kriteret specifike të kërkuara nga institucioni, të cilat janë:

Të jetë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë;

Të ketë kaluar Vetting-un;

Të ketë mbaruar studimet në Shkollën e Magjistraturës;

Të jetë vlerësuar minimalisht "shumë mirë" nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Të ketë marrë leje nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Të ketë bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës në trajnimin vazhdues;

Të ketë qenë ekspert/lehtësues në trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

Të jetë njohës i mirë i një ose disa gjuhëve të huaja.

Në pikën 6 të këtij Kreu, përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve dhe kritereve të kandidimit, konkretisht parashikohet që Këshilli mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 7 të Kreut II, përcaktohet procedura që do ndiqet nga i Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ky vlerësim do bëhet brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.

Projekt-opinioni për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre.

Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera ose kriteret e komandimit, me përjashtim të atij të mësimdhënies.

Lidhur me këtë përjashtim mbahet parasysh se, si rregull, referuar pikës 4, të nenit 52, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli duhet të verifikojë kriteret e komandimit për çdo aplikant. Por, në rastin e mësimdhënies, ky është një kriter specifik, vlerësimi i saktë i të cilit mund të bëhet nga një institucion akademik, sikundër është dhe Shkolla e Magjistraturës. Përveç kësaj, praktikisht është e mundur që edhe të dhënat e mësimdhënies për aplikantët duhet të jepen dhe konfirmohen nga Shkolla e Magjistraturës, pranë së cilës gjyqtarët marrin pjesë si trajnues.

Sipas përcaktimit të bërë në pikën 8 të këtij Kreu, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre.

Në pikën 9 të këtij Kreu, parashikohet se vlerësimi i kriterit të komandimit të mësimdhënies dhe i kritereve shtesë për pozicionin vakant si më sipër, bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, në zbatim të Rregullores së Brendshme të miratuar prej saj. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatin për depozitimin pranë saj të çdo dokumentacioni tjetër shtesë, me qëllim vlerësimin e plotësimit të kritereve të tjera të parashikuara në Aneksin 11 të Rregullores.

Në pikën 10 të këtij Kreu, përcaktohet se, përzgjedhja e kandidatit për vendin vakant në pozicionin e pedagogut të brendshëm, bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Në pikën 11 të këtij Kreu, përcaktohet se, brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe të kërkesës për komandim nga Shkolla, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarit të përzgjedhur, në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës.

Së fundi, parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe u komunikohet gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë sugjerim lidhur me draftin e propozuar?

Brikena Ukperaj: Atëherë, unë jam dakord me propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dakord edhe me propozimin që kriterin e eksperiencës në punë është Shkolla që e vlerëson (qëndrim që kemi mbajtur edhe herë të tjera për kandidatët), por dua të saktësoj që ndoshta duhet të jetë më e saktë në projekt-akt që Këshilli në këtë rast vlerëson vetëm kushtet e komandimit. Pra për të qenë në koherencë me atë që themi, tek pika nr. 7, kemi thënë: “Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit ku komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të komandimit”.

Ne nuk vlerësojmë asnjë kriter komandimi sipas këtij vendimi.

Pra në vendim i kemi të ndara kushtet e komandimit, kriteret e komandimit dhe kriteret specifike. Këshilli vlerëson vetëm kushtet e komandimit. Asnjë nga kriteret e komandimit, Këshilli nuk merr në vlerësim.

Pra: "...nuk plotëson ndonjë prej kushteve të komandimit." – duke hequr këtë "...ose kritere të tjera me përjashtim të atij të mësimdhënies".

Pra Këshilli vlerëson vetëm nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të komandimit. Kështu është edhe në relacion.

Duke qenë se ne i kemi ndarë në kushte dhe në kritere, ne nuk do shohim asnjë nga kriteret që do t'i vlerësojë Shkolla (është diskrecion i Shkollës).

Klodian Kurushi: Në relacion është thënë.

Brikena Ukperaj: Po, është thënë në relacion. Thjesht për të përshtatur atë që ju thatë në relacion, me atë që është shkruar.

Naureda Llagami: Atëherë, e hedhim në votim, bashkë me sugjerimin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni dhe kundër ndryshimit të kërkuar tani.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri më datë 13 shkurt 2023.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional dhe do të relatohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Duke qenë se relacioni është i detajuar, po përpiqem që ta përmbledh.

Zoti {...} ka qenë i përfshirë në listën e gjyqtarëve të cilët do t'i nënshtroheshin vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, gjatë kohës që ai e kishte statusin e gjyqtarit.

Gjatë zhvillimit të procedurave të vlerësimit, gjyqtari është shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit *(në vijim KPK*).

Në vijim për këtë gjyqtar është bërë pezullimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional deri në përfundimin e shqyrtimit të vendimit të KPK-së nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit *(në vijim KPA).*

KPA-ja ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KPK-së për sa i përket subjektit të rivlerësimit z. {...}. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

Për shkak të vendimit të KPK-së, gjyqtari e ka humbur statusin e tij sepse ka një masë disiplinore "shkarkim nga detyra" dhe në këto kushte është e pamundur që të vijojë procedura e vlerësimit etik dhe profesional.

Për këtë arsye kemi kërkuar nëpërmjet këtij projektvendimi, përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarit {...}, situatë të cilën e kemi parashikuar edhe në rregulloren me rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve.

Projekt-akti është i hartuar në tre pika.

Në pikën e parë është parashikuar ajo çka unë relatova, përfundimi i procedurës së vlerësimit për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

Në pikën e dytë është njoftimi i vendimit.

Në pikën e tretë e drejta e ankimit e cila, duke qenë se jemi para një akti administrativ individual, jemi të detyruar që ta parashikojmë.

Së fundmi është parashikuar edhe hyrja e tij në fuqi.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, në qoftë se keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor *(pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit).*

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë me projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për magjistraten {...}. Sërish fjalën e ka zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Edhe ky projekt-akt vjen si rezultat i humbjes së statusit të magjistratit nga ana e zonjës {...}, për të cilën nga ana e Këshillit është miratuar dorëheqja. Ndërkohë edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim KPK-ja*) është vendosur ndërprerja e procesit të rivlerësimit me detyrimin e ndalimit 15-vjeçar të parashikuar në ligj.

Zonja {...} ka qenë edhe ajo e përfshirë në programin e vlerësimit të viteve 2017-2019.

Gjatë ecurisë së procedurave të vlerësimit gjyqtarja ka dhënë dorëheqjen. Dorëheqja është miratuar nga ana e Këshillit.

Në vijim, nga ana e KPK-së është vendosur edhe ndërprerja e procesit të rivlerësimit.

Në këto kushte, për shkak të humbjes përsëri të statusit të magjistratit, por për një shkak të ndryshëm nga akti i relatuar më parë, Këshilli, për të njëjtat arsye, ka vendosur t'i propozojë plenares përfundimin e procedurës së vlerësimit për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit për zonjën {...}.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse s'kemi diskutim, kalojmë në votim të projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro. *(Vota e zotit Hallunaj nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: "... Vota ime për të dy pikat e rendit të ditës datë 27.01.2023, është pro". E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...} për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor *(pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit).*

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projekt-aktit për përfundimin pa vendim përfundimtar për magjistraten {...}. Zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Shkurtimisht po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur relacionin lidhur me projektvendimin për përfundimin e procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar, për gjyqtaren {...}.

Procedura e vlerësimit për këtë gjyqtare ka filluar me vendimin nr. 440, datë 01.11.2022 pas ardhjes së dosjes nga organet e rivlerësimit. Nëpërmjet këtij vendimi është përcaktuar vlerësuesi dhe nëpunësja përgjegjëse.

Gjithashtu, po në datën 2.11.2022 është njoftuar gjyqtarja lidhur me vlerësuesin dhe kjo e fundit nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim lidhur me vlerësuesit.

Në vijim të procedurës, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes të përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar, të dosjes personale të gjyqtares, ka rezultuar se zonja {...}, për periudhën tetor 2011 deri në shtator 2014 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2013 deri në muajin korrik 2014 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin e Presidentit të Republikës nr.{...}, datë 25.09.2015, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, znj. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares në dy periudha:

(i) Praktikën profesionale tetor 2013 deri në muajin korrik 2014, për një kohëzgjatje prej 9 muajsh;

(ii) Funksionin e gjyqtares nga data 25.09.2015 deri në datën 08.10.2016, për një periudhë kohore 1 vit e 12 ditë. Gjatë kësaj periudhe ajo ka qenë me leje lindje nga muaji shkurt 2015 deri në muajin qershor 2015, duke u paraqitur në punë në datë 01.07.2016.

Për sa i përket periudhës së stazhit profesional në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në ligjin e kohës nr.8136, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, është përcaktuar se vlerësimi i magjistratëve për stazhin profesional bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, në përfundim të së cilës bëhet vlerësimi dhe pikëzimi i magjistratëve, me qëllim emërimin e tyre. Stazhi profesional ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtares gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës, i është nënshtruar vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës. Për pasojë, kjo periudhë vlerësimi nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit, pavarësisht se gjyqtarja ka pasur statusin e gjyqtares edhe gjatë kësaj praktike profesionale.

Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar vlerësimi, nuk mund të mbivendoset me periudhën e vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Referuar ligjit për statusin, neni 171, pika 5 e këtij ligji, parashikon se: "Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës".

Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të znj. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 2013-2016, rezulton se ajo ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën rreth 1 vit e 12 ditë. Nëse vitin 2016 do ta konsiderojmë vit të plotë (pra jo nga muaji tetor por deri në dhjetor të këtij viti), kohëzgjatja e detyrës së gjyqtares përkon me 1 vit, 4 muaj e 6 ditë. Gjatë kësaj periudhe vlerësimi, gjyqtarja ka qenë me leje lindje nga data 01.02.2016 deri datë 01.07.2016, pra për një periudhë prej 5 muajsh. Kështu, gjyqtarja ka ushtruar efektivisht detyrën e gjyqtares për një periudhë prej 11 muaj e 6 ditë, duke e marrë vitin të plotë që muajin tetor, për të cilën është përcaktuar periudha e gradimit. Gjatë kësaj periudhe, gjyqtari gëzon statusin e gjyqtarit si dhe kjo periudhë i njihet për efekt të vjetërsisë në punë, në kushtet kur sipas nenit 8 paragrafi 3 të ligjit "Për sigurimet shoqërore", i ndryshuar si dhe nenit 9 paragrafi i parë i këtij ligji, gjatë kësaj periudhe paguhen sigurimet shoqërore për efekt pensioni. Gjithashtu, sipas ligjit "Për statusin", i ndryshuar, kjo periudhë njihet dhe llogaritet si përvojë profesionale të gjyqtarit, edhe për efekt të përcaktimit të periudhës së vlerësimit, në ndryshim nga leja e papaguar, e cila nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera.

Në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, sa i përket periudhës së vlerësimit, parashikohet se:

"1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar."

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019, neni 5, në pikën 4 të tij, përcaktohet se: "4. Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit."

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për znj. {...}, në kushtet kur rezultoi se koha e ushtrimit të detyrës për periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi në kuptim të nenit 84 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 263/2019, procedura e vlerësimit etik dhe profesional të filluar për periudhën 3-vjeçare që përfshin këtë periudhë nuk mund të vazhdojë. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1-vjeçar, është miratuar nga Këshilli, për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim.

Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtarja, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë profesionale për një kohëzgjatje minimale prej një viti, brenda periudhës së vlerësimit, rezulton se, objekti për të cilin ka filluar procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) është i pamundur të realizohet dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure vlerësimi nuk mund të vazhdojë, pasi gjyqtarja nuk ka ushtruar detyrën për një kohë 1-vjeçare të kësaj periudhe.

Sa më sipër, ne propozojmë përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit, duke përcaktuar edhe pikat e vendimit. Konkretisht përcaktohet përfundimi pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për shkak se objekti për të cilën kishte nisur kjo procedurë është i pamundur të realizohet, pasi koha e ushtrimit të detyrës nga gjyqtarja, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën 2 përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares.

Në pikën 3 është përcaktuar e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi.

Në pikën e fundit përcaktohet hyrja në fuqi dhe botimi i menjëhershëm në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë gjë, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit " Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin {...}", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e tretë *(me të njëjtin objekt)* e cila ka të bëjë me përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtarin {...}.

Siç jeni vënë në dijeni, nga zoti Çupi është kërkuar që të jetë prezent, por për arsye shëndetësore është në pamundësi për të qenë prezent sot. Bashkëlidhur ka sjellë një raport për "paaftësi në punë", që dëshmon paaftësinë e tij objektive për të qenë në mbledhjen e Këshillit.

Për këtë arsye, këtë çështje e shtyjmë për një mbledhje tjetër.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër sipas rendit të ditës, që ka të bëjë me hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, e cila është një çështje që vjen si bashkëpropozim i dy komisioneve, zhvillimit të karrierës dhe komisionit të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale. Do të relatohet nga zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Relacioni i radhës ka për objekt miratimin e projektvendimit për hapjen e

procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për të bërë të mundur realizimin e detyrimeve kushtetuese të parashikuara në nenin 147 të Kushtetutës dhe atyre të akteve ligjore që diktojnë ligjet e reformës në drejtësi, si një organ që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, përgjatë veprimtarisë së tij, ka detyrimin të miratojë një numër të madh aktesh administrative të natyrës normative, individuale, rregullore të brendshme e udhëzime jodetyruese. Për të bërë të mundur këtë duhet:

i) një strukturë organizative mirëfunksionale e tij dhe e administratës;

ii) përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha njësive organizative dhe pozicioneve individuale;

iii) rregulla procedurale, sipas të cilave vepron administrata në mënyrë të tillë që të bashkëpunojë e bashkërendojë punën, për të siguruar mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Në funksion të sa më sipër, Këshilli ka miratuar me vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 strukturën organizative të administratës, e cila është përmirësuar më tej, duke parashikuar në këtë strukturë, ndër të tjera, edhe Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Kjo njësi mbështet dy nga komisionet e ngritura në KLGJ, atë të përhershëm për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe atë të përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve ka në organikën e saj 7 pozicione nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, nga të cilët 5 janë aktualisht të zëna dhe një pozicion është vakant. Aktualisht të gjithë nëpunësit përgjegjës për vlerësimin kanë statusin e magjistratit. Për shkak të ecurisë së procesit të vlerësimit periodik, gradimit e vlerësimit të përshpejtuar dhe atij ndihmës për organet e rivlerësimit, ku nëpunësi përgjegjës për vlerësimin konsiderohet edhe ai për efekt të ligjit "vlerësues", është nevojë urgjente plotësimi i kësaj strukture. Prandaj, për të pasur kontributin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e gjyqësorit, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

propozon që pranë kësaj njësie të komandohet edhe 1 gjyqtar tjetër. Për këtë komisionet iniciues të këtij projektvendimi, mbështetur në nenin 79, shkronja "b", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", propozojnë që Këshilli të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e një pozicioni "nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

I. Vlerësimi i Komisioneve

Referuar nenit 54 pika 2 të Ligjit për Statusin, në një procedurë komandimi, Këshilli shpall kërkesën për kandidatura, gjithmonë pasi ka bërë vlerësimin e nevojave të tij, duke nënkuptuar nevojat e gjithë sistemit ku dhe ai bën pjesë. Në rastin konkret krijohet perceptimi i përballjes së nevojave që kanë vetë aktorët e sistemit të drejtësisë. Këshilli ka nevojë për një staf të kualifikuar që duhet të vijë nga radhët e gjyqtarëve, ndërkohë që edhe gjykatat kanë nevojë për gjyqtarë. Por për shkak të emërimit të të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës, ka pritshmëri të zbutjes së shkallës së cenimit të funksionalitetit të gjykatave të shkallës së parë, e në këtë këndvështrim, komandimi i një gjyqtari në pozicionin e nëpunësit përgjegjës është i mundshëm.

Me anë të këtij projektvendimi që ne propozojmë, synojmë të rregullojmë shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit nëpunës përgjegjës për vlerësimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen e shpalljes, kriteret e vendosura dhe procedurën e komandimit në këtë pozicion.

II. Struktura e projektvendimit

Në kreun e parë të vendimit, shpallja e kërkesës për kandidatura, ku përcaktohet në pikën e parë hapja e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në pikën e dytë përcaktohet se kërkesa shpallet për plotësimin e 1 pozicioni "nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Në pikën e tretë, lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesave parashikohet se Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është edhe në këtë rast opsionale, 15

(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose opsioni i dytë, ne propozojmë datën 13.02.2023 si një datë fikse të caktuar në varësi të shqyrtimit nga mbledhja plenare, të cilën ne po e mbajmë ditën e sotme.

Në pikën 4 të këtij kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati që do aplikojë në këtë procedurë. Këto dokumente përfshijnë kërkesën me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim për pozicionin e shpallur; jetëshkrimin, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij; certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj, pesë dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës; vetëdeklarim për mosndodhjen në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor; rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup; çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kritereve të komandimit.

Në kreun e dytë, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit të gjyqtarit.

Në pikën e parë të këtij kreu parashikohet se kohëzgjatja e komandimit do jetë 2 (dy) vjet, me të drejtë ripërsëritje brenda afatit 5-vjeçar.

Në pikën e dytë të këtij kreu parashikohet se cilat janë rastet e përfundimit të komandimit para afatit, të tilla si: me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara; kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit; kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore; kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen; kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra; për shkak të konfliktit në dukje të interesit të shkaktuar në rast se gjyqtari gjatë periudhës së komandimit aplikon për ngritje në detyrë ose për lëvizje paralele.

Kjo pikë e fundit është parashikuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Sipas përkufizimeve të këtij ligji “Konflikt i interesit” është gjendja e

konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike; forma të tjera të konfliktit të interesit b) "konflikt në dukje i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë. Ndërsa në nenin 5 ku parashikohen format e interesave privatë, germa "ç" përcakton se: "negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës".

Gjithashtu në pikën 3 të kreut të dytë, jepen kriteret e komandimit që janë: eksperienca në punë si gjyqtar jo më pak se 3 vjet; komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; kandidati të mos jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; kandidati të mos jetë i komanduar; kandidati që ka qenë i komanduar më parë, i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit dhe ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës; kushti që kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi; kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmerisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë".

Në pikën 4 të këtij kreu, përcaktohen rastet kur një kandidat ka përparësi gjatë procedurës së përzgjedhjes. Si e tillë ai duhet të ketë ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatorë; duhet të ketë njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor;

duhet të jetë autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; duhet të ketë njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian; si dhe duhet të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, personale dhe angazhimi profesional, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Në pikën 5, përcaktohet dokumentacioni mbi bazën e të cilit do bëhet vlerësimi, që mund të jetë dokumentacioni i paraqitur nga vetë ai, dokumentacioni i administruar nga Këshilli apo dokumentacioni që ndodhet në dosjen personale të kandidatit si dhe në çdo dokument tjetër që mund të merret nga burimet e përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në pikën 6, përcaktohet procedura që do ndiqet nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vlerësimin nëse komandimi i kandidatëve është apo jo në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin. Kjo gjë do bëhet brenda dy javëve pas afatit të aplikimit. Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat i cili shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare. Këshilli vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin apo kur për kandidatin verifikohet ndonjë prej kritereve të tjera ndaluese të komandimit.

Në pikën 7 të këtij kreu, përcaktohet procedura që do zbatohet pas vlerësimit të bërë sipas pikës 6. Procedura vijon me vlerësimin e kritereve të përparësisë së kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi sipas pikës 6 të këtij kreu. Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili, kur çmon të nevojshme, mund të intervistojë kandidatin për verifikimin e kritereve të kandidimit. Intervista dokumentohet në një procesverbal me shkrim.

Në pikën 8, përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale brenda dy javëve duhet të paraqesë përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor një raport ku pasqyrohen të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kritereve të kandidimit, përfshirë edhe atyre preferenciale bashkë me renditjen e tyre, duke filluar

nga kandidati i vlerësuar më mirë. Krahas kësaj, Komisioni i paraqet Këshillit dhe një propozim për komandim me emrin e kandidatit të renditur më lart.

Në pikën 9, parashikohet se brenda një jave nga paraqitja e raportit dhe propozimit për komandim, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor thërret mbledhjen plenare, për të vendosur në lidhje me komandimin e gjyqtarit kandidat në pozicionin e mësipërm.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 10, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos komandimin për gjyqtarin kandidat të propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Gjithashtu në këtë pikë përcaktohet se në rast të mosmiratimit të propozimit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër kandidat që plotëson kriteret e komandimit. Ky propozim i nënshtrohet votimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë në pikën e fundit të vendimit rregullohet situata ligjore kur asnjë prej gjyqtarëve kandidatë nuk komandohet. Në këtë rast Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e 1 pozicioni "nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Njësinë Mbështetëse të Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutim, kalojmë në votim të projekt–aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro. *(Vota e zotit Hallunaj nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: "... Vota ime për të dy pikat e rendit të ditës datë 27.01.2023, është pro". E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Hapjen e procedurës për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri në datë 13 shkurt 2023.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 "Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}",

7.2 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...};

7.3 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...};

7.4 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...};

7.5 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...}.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***

4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 "Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}";

7.2 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...};

7.3 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...};

7.4 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...};
7.5 Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...}.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e radhës, që ka të bëjë në fakt me një grup projekt-aktesh që lidhen me përfundimin para afateve të shërbimit në skemë delegimi të zonjës {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Pra janë të gjitha këto projektvendime të cilat i përmendi Kryetarja, unë s'po i përmend edhe një herë, që kanë një objekt të përbashkët, përfundimin para afatit të shërbimit në skemë delegimi për gjyqtarët që u përmendën.

Pa humbur kohë po filloj me prezantimin e relacionit. *(Ripërsëritet objekti)*

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgjegjësinë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, e Kushtetutës) dhe në veçanti funksionin e transferimit të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja "a", e Kushtetutës). Në përmbushje të përgjegjësisë së komandimit të gjyqtarëve (neni 86, shkronja "d", të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar) dhe të caktimit të tyre në skemën e delegimit (neni 45 i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin"), por mbi të gjitha nisur nga nevojat e funksionalitetit të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, KLGJ-ja ka caktuar disa gjyqtarë në skemën e delegimit të ngritur pranë këtij Këshilli.

Gjyqtarët e skemës së delegimit, të cilët janë caktuar për të gjykuar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për një afat të caktuar janë:

i) {...} – caktuar në Gjykatën e Apelit Shkodër;

ii) {...} – caktuar në Gjykatën e Apelit Durrës;

iii) {...} – caktuar në Gjykatën e Apelit Vlorë;

iv) {...} – caktuar në Gjykatën e Apelit Vlorë;

v) {...} – caktuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër;

vi) {...} – caktuar në Gjykatën e Apelit Korçë, me leje lindje prej datës 15.10.2022.

Gjyqtarët e mësipërm, janë bërë pjesë e skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 45 të Ligjit 96/2016 dhe Vendimit nr. 22, datë 07.02.2019 "Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit". Këta gjyqtarë janë përfshirë në skemën e delegimit, si një mekanizëm për të përballuar situatën e vështirë në të cilën janë gjendur gjykatat e apelit. Numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë, në raport me organikën dhe fakti që referuar Kodeve të Procedurës Civile dhe Penale, gjykata e apelit gjykon me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë, e ka detyruar Këshillin që këta gjyqtarë t'i caktojë për të gjykuar sipas afatit të skemës në gjykatat e apelit.

Pas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave", Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr. 505, datë 21.11.2022, "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", i cili përcakton parimet mbi të cilat do të behet riorganizimi i gjykatave të apelit dhe fillimin e funksioneve më datë 01.02.2023 të funksionimit të një gjykate të vetme apeli, me juridiksion të përgjithshëm, me kompetencë tokësore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me vendimin nr. 553, datë 28.12.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcaktuar se: "Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 78 (shtatëdhjetë e tetë) gjyqtarë."

II. Vlerësimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës

Në vendimet respektive të gjyqtarëve znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...} të cilat janë miratuar më parë në kohë se vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave", është parashikuar afati i skemës së delegimit deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

Ndërsa në vendimin e Këshillit për zgjatjen e afatit të skemës së delegimit për gjyqtarin Laurent Fuçia, dhe ricaktimin e tij për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, u mbajt në konsideratë fakti se më datë 01.02.2023 fillonte funksionimin Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe afati si i caktuar në skemën e delegimit u zgjat deri më 01.02.2023.

Rregullorja “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, në nenin 14 Përfundimi i shërbimit në skemën e delegimit parashikon se:

“ 1. Shërbimi në skemën e delegimit përfundon në afatin e caktuar në vendimin e Këshillit. Në këtë rast, gjyqtari kthehet automatikisht në gjykatën ku ka pasur emërimin pa pasur nevojën e një vendimi të ri të Këshillit.

2. Me vendim të Këshillit, koha e shërbimit në skemën e delegimit mund të përfundojë para afatit të përcaktuar:

a) në bazë të kërkesës së motivuar nga ana e gjyqtarit;

b) kur merret një masë disiplinore që e pengon pjesëmarrjen në skemën e delegimit;

c) kur verifikohet një rast i ndërprerjes së përkohshme të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.

3. Në këtë rast Këshilli mund të vendosë që gjyqtari të ndërpresë menjëherë gjykimin e çështjeve në shqyrtim.

4. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, përfundimi i shërbimit mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni”.

Nisur nga kjo situatë, Komisioni duke mbajtur në vëmendje përcaktimin e pikës 4, të neni 14, të Vendimit të sipërpërmendur të Këshillit, sipas të cilit: “... 4. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, përfundimi i shërbimit mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni”, rasti objekt shqyrtimi përbën një rast të justifikuar për të përfunduar skemën e këtyre gjyqtarëve përpara afatit.

Ndodhemi përpara rastit të justifikuar pasi: i) Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr. 505, datë 21.11.2022, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i cili përcakton fillimin më datë 01.02.2023 të funksionimit një gjykate të vetme apeli, me juridiksion të përgjithshëm, e kompetencë tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; ii) gjykatat ku më parë ishin caktuar si gjyqtarë të skemës së delegimit, pushojnë së funksionuari pas datës 1 shkurt 2023, kompetencat tokësore të të cilave janë përthithur nga Gjykata e Apelit të

Juridiksionit të Përgjithshëm. Riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave në një gjykatë të vetme apeli të juridiksionit të përgjithshëm, passjell mbarimin e ekzistencës si persona juridikë të 5 gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm; iii) vendimmarrja e Këshillit për pranimin e kërkesave të tyre për caktimin në skemë delegimi ka qenë e lidhur ngushtësisht me garantimin e funksionalitetit të gjykatave të apeleve, të shpallura si pasojë e gjendjes së veçantë, si gjykata në nevojë; iv) mbajtur në konsideratë edhe një qëndrim të mëparshëm të Këshillit për gjyqtarin {...}, dhe ricaktimin e tij për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Vlorë (kjo konsideratë është marrë parasysh edhe në hartimin e këtij relacioni dhe përgatitjen e projektvendimeve përkatëse), për ricaktimin e të cilit u mbajt në konsideratë fakti se më datë 01.02.2023 fillonte funksionimin Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe afati si i caktuar në skemën e delegimit për këtë gjyqtar u zgjat deri më datë 01.02.2023.

Për sa më sipër, verifikohet një shkak për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për: znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}; z. {...}.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, nisur nga kjo situatë ka përgatitur projektvendimin "Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit", për këta gjyqtarë.

Në këto rrethana, vlerësohet se Këshilli duhet të shprehet për përfundimin e shërbimit në skemën e delegimit:

i) për znj. {...}, për të cilën, është vendosur më përpara me vendimin nr. 112, datë 28.03.2022: "1. Zgjatjen e afatit të caktimit në skemë..."

Nga ana tjetër, marrë shkas nga situata në Gjykatën e Apelit Korçë, funksionaliteti i të cilës ishte cenuar për shkak të qenies në detyrë të vetëm tre gjyqtarëve, (ku dy gjyqtarë, përfshirë edhe znj. {...} ishin në skemë delegimi) ndërkohë që znj. {...} ka konsumuar vetëm një vit nga kjo periudhë, Këshilli ka vlerësuar në atë kohë se është vendi për të zgjatur afatin e caktimit të saj në skemë delegimi. I referohem vendimit nr. 113, datë 28.03.2022, ku zonja {...} është ricaktuar në skemën e delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për periudhën deri më datë 25.03.2022.

ii) për znj. {...} – i referohemi vendimit nr. 228, datë 20.06.2022, ku Këshilli për të ka vendosur: "1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}. 2. Caktimin e gjyqtares

znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat njëvjeçar, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave. ...”.

Zonja {...} është caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për të gjithë periudhën e caktimit në skemë delegimi, pra deri në datën 20.06.2023.

iii) për z. {...} – i referohemi vendimit nr. 199, datë 31.05.2022, ku kemi zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të z. {...} dhe efektet juridike të tij fillonin në datë 09.06.2022.

Referuar vendimit të zgjatjes, skema e delegimit për zotin {...} do të vijonte të funksiononte deri në datë 9.06.2023.

iv) për z. {...}, për të cilin me vendimin nr. 224, datë 20.06.2022, Këshilli kishte vendosur pranimin e tij në skemën e delegimit. Caktimin si gjyqtar në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me një afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

Zoti {...} është caktuar për të gjykuar në skemë delegimi në Gjykatën e Apelit Gjirokastër për të gjithë periudhën e caktimit në këtë skemë, deri më datë 20.06.2023.

v) në të njëjtën situatë ndodhet edhe zoti {...}, dhe me të njëjtat afate kemi vendosur edhe për zotin {...}, i cili është caktuar në Gjykatën e Apelit Durrës.

III. Struktura e projektvendimeve

Projektvendimi është i strukturuar në pesë pika.

Në pikën e parë, parashikohet përfundimi para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarët përkatës. Projektvendimet janë nominativë për secilin gjyqtar.

Në pikën e dytë parashikohet se efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2023.

Në pikën e tretë parashikohet fati që do të ndjekin çështjet gjyqësore që janë në shqyrtim prej tyre, ku parashikohet se: Për çështjet gjyqësore të ngarkuara kësaj ose këtij gjyqtari do të ndiqen rregullat e përgjithshme procedurale të rishpërndarjes së çështjeve me short dhe ato për plotësimin e trupit gjykues.

Po e përsëris edhe një herë: Për çështjet gjyqësore të ngarkuara pranë këtij ose asaj gjyqtareje (në varësi të projektvendimit për gjyqtarin përkatëse) do të ndiqen rregullat e përgjithshme procedurale (kemi shtuar ne) “të rishpërndarjes së çështjeve

me short” dhe ato për plotësimin e trupit gjykues. Pra janë rregulla procedurale të rishpërndarjes dhe të plotësimit të trupit gjykues.

Për të vijuar më tej, në vijim parashikohet edhe njoftimi i këtyre vendimeve sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe gjykatave respektive, aty ku janë të caktuar në mënyrë të përhershme, dhe gjykatat ku ushtrojnë detyrën si gjyqtar i skemës së delegimit.

Gjithashtu parashikohet edhe e drejta e ankimit - Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe publikimi i vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më duhet të shtoj që pasi kemi përgatitur projektvendimet dhe relacionin, janë paraqitur dy kërkesa, nga gjyqtarët znj. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë kërkuar vijimin e qëndrimit në skemë delegimi. Zonja {...} ka kërkuar në kërkesën e saj me preferencë që të vijojë qëndrimin në skemë delegimi në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (shkalla e parë), duke dhënë edhe deklaratat personale për veten dhe për bashkëshortin e saj, sipas kritereve të parashikuara në ligjin e posaçëm. Ndërkohë që, zoti {...} ka paraqitur kërkesën e tij për të vijuar qëndrimin në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kjo është preferenca e tij. Janë bashkëngjitur këtij relacioni për shkaqe se këto kërkesa kanë ardhur më pas se ne të kemi përgatitur relacionin përkatës. Faleminderit!

(Anëtarët flasin paraprakisht pa ndezur mikrofonat lidhur me dy kërkesat që i janë bashkëlidhur relacionit të sipër relatuar. Rifillon më pas shqyrtimi i çështjes.)

Naureda Llagami: Vijojmë sipas propozimit të sjellë nga Komisioni lidhur me përfundimin para afatit të shërbimit në skemë delegimi për gjyqtaren znj. {...}.

Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2023.

3. Për çështjet gjyqësore të ngarkuara kësaj gjyqtareje do të ndiqen rregullat e përgjithshme procedurale të rishpërndarjes së çështjes me short dhe ato për plotësimin e trupit gjykues.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e dytë që edhe kjo ka të bëjë me përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtaren znj. {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

1. Edhe për këtë gjyqtare përfundohet para afatit të shërbimit skema e delegimit

2. Efektet e vendimit fillojnë më datë 01.02.2023.

3. Për çështjet gjyqësore të ngarkuara kësaj gjyqtareje do të ndiqen rregullat e përgjithshme procedurale të rishpërndarjes së çështjeve me short dhe ato për plotësimin e trupit gjykues.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin tjetër që ka të bëjë me përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtarin z. {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Edhe për këtë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2023.

3. Për çështjet gjyqësore të ngarkuara këtij gjyqtari do të ndiqen rregullat e përgjithshme procedurale të rishpërndarjes së çështjeve me short dhe ato për plotësimin e trupit gjykues.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Apelit Shkodër.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtarin z. {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Edhe për gjyqtarin z. {...}:

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2023.

3. Për çështjet gjyqësore të ngarkuara këtij gjyqtari do të ndiqen rregullat e përgjithshme procedurale për rishpërndarjen e çështjeve me short dhe ato për plotësimin e trupit gjykues.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i fundit që ka të bëjë me përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit për gjyqtarin z. {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtarin z. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 01.02.2023.

3. Për çështjet gjyqësore të ngarkuara këtij gjyqtari do të ndiqen rregullat e përgjithshme procedurale për rishpërndarjen e çështjeve me short dhe për plotësimin e trupit gjykues.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, siç u dakordësuam të gjithë bashkë, për kërkesat, shprehjen e vullnetit mbi skemën e delegimit, nga ana e Komisionit do të bëhet një vlerësim i të gjithë kërkesave që janë paraqitur me këtë objekt.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Largohet gjatë trajtimit të kësaj çështjeje zonja ***Marçela Shehu***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për komandimin e gjyqtares znj. {...} në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Sërish zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86, shkronja "d", të Ligjit nr.115/2016, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. vendimin nr. 486, datë 14.11.2022 ka vendosur: "Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për "Këshilltar"; 2. Afati i paraqitjes së kërkesave për

komandim është data 30 nëntor. 3. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë paraqitur kërkesë 2 kandidatë.

Me shkresën nr. {...}, datë 18.11.2022, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Zonja {...} ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pozicionin "Këshilltar". Me shkresën nr.{...}, datë 23.11.2022 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtares {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Zonja {...} ka shfaqur gjithashtu vullnetin për t'u komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pozicionin "Këshilltar".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të opinionit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr.548, datë 22.12.2022 "Për dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t'u komanduar në pozicionin "Këshilltar" në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka dërguar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë emrat e gjyqtareve: znj. {...}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe znj. {...}, të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 11.01.2022, bazuar në nenin 54, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kërkuar Këshillit komandimin e gjyqtares znj. {...} në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në respektim të përcaktimit të bërë në pikën 5, të nenit 54, të Ligjit nr. 96/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin të shqyrtojë kërkesën e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë brenda dy javëve nga marrja e saj, duke përcaktuar, nëse është rasti, dhe kushtet e komandimit.

Lidhur me afatin e komandimit. Neni 54, pika 1, i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ka parashikuar një afat maksimal të komandimit deri në 5 vjet, afat të cilin edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar në rastin konkret. Duke mbajtur në konsideratë se si rezultat i zbatimit të Ligjit nr. 84/2016 datë 06.10.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" në të ardhmen mund të ndodhemi në situatën e cenimit të

funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila pas implementimit të hartës së re gjyqësore (1 maj 2023), do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson që në kuptim të nenit 57, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016, në vendimin e komandimit të parashikohet edhe mundësia e ndërprerjes së komandimit përpara afatit kur një gjë e tillë do të jetë e domosdoshme për interesat më të larta të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe në alternativë, pas datës 1 maj 2023, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Të komandojë gjyqtaren znj. {...} në pozicionin "Këshilltar" në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një afat deri në pesë vjet.

2. Të përcaktojë fillimin e afatit të komandimit më datë 1 shkurt 2023 (në varësi edhe të shqyrtimit të këtij projekti nga Këshilli).

3. Të përcaktojë që afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ose në alternativë, pas datës 1 maj 2023, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Të urdhërojë përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk keni diskutime?

Paraprakisht, zonja Shehu nuk është në mbledhje plenare, për shkak të një angazhimi ku përfaqëson Këshillin.

Kështu që propozoj hedhjen në votim të projekt–aktit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin "Këshilltar" në Zyrën e Inspektorit, për një afat deri në pesë vjet.

2. Afati i komandimit fillon më datë 1 shkurt 2023.

3. Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë/Fier.

4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit z. {...} në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm" i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk merr pjesë në këtë çështje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zonja Marçela Shehu***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit "Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit z. {...} në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm" i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit z. {...} në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm", i përgatitur edhe ky nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Do të relatohet nga zoti Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Zoti {...} është gjyqtar i Republikës së Shqipërisë, si i tillë, subjekt i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë". Duke qenë se në kohën e rivlerësimit ka pasur caktimin e përkohshëm në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe ka marrë masën e shkarkimit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera ka vendosur transferimin e tij pa pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj tij, në kuadër të procesit të rivlerësimit janë marrë këto dy vendime:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 245, datë 03.03.2020, ka vendosur: Shkarkimin e tij nga detyra si subjekt i rivlerësimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas këtij vendimi, me vendimin nr. 130, datë 30.03.2020, pas dhënies së vendimit nr. 245, datë 03.03.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka vendosur:

1. Deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Transferimin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjyqtari z. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë i garantohet magjistratit referuar nenit 44, pika 2, shkronja "b", e Ligjit "Për statusin".

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, më pas me vendimin nr.34, datë 21.09.2022 ka vendosur:

"1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 245, datë 05.03.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit z. {...} dhe konfirmimin e tij në detyrë.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm."

Aktualisht, z. {...}, bazuar në vendimin nr. 130, datë 30.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhoma penale, si i transferuar pa pëlqim me vendimin përkatës.

Vendimi nr. 130, datë 30.03.2020 i Këshillit është marrë bazuar në nenin 44, pika 1, shkronja "b" dhe nenin 162, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ndryshimet në strukturën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku ka ushtruar më parë funksionin magjistrati z. {...}, në mënyrë të veçantë parashikohen në nenin 162, pikat 1, dhe 4, të këtij ligji, i cili parashikon si më poshtë:

"1. Gjyqtari në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ose Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda qëndron në pozicion deri në momentin e krijimit të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin përkatës. [...].

4. Në rast se ndaj gjyqtarit të caktuar përkohësisht, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendoset masë disiplinore, në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", caktimi i përkohshëm i tij mbaron pavarësisht nëse është bërë ose jo ankim ndaj këtij vendimi".

Për sa më lart, këto parashikime ligjore, në mënyrë eksplicite përcaktojnë mundësinë e suprimimit të pozicionit të gjyqtarit për shkak të vendimit të shkarkimit nga detyra nëpërmjet vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar bazuar në ligjin nr.84/2016.

II. Vlerësimi i Komisionit.

Bazuar në pikën 3 të vendimit nr. 130, datë 20.03.2020 të Këshillit, të cilën ne e cituam më lart, si dhe nenit 44, pika 2, shkronja "b", e Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli duhet të fillojë procedurat për transferimin e z. {...} në gjykatat e shkallës të juridiksionit të përgjithshëm, në pozicionet e lira.

Situata në gjykatat e juridiksionin të përgjithshëm, siç u vlerësua me vendimet e Këshillit nr.11- nr.32, datë 18.01.2023 dhe relacioni që shoqëroi këto vendime, paraqitet më emergjente në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës.

Gjendja e tyre është e integruar në relacionin përkatës. Unë s'po i lexoj një nga një numrin dhe ngarkesën që kanë gjyqtarët në gjykatat respektive të rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës.

Në këto kushte, pozicione të lira, dhe që i propozohen z. {...}, janë:

i) Një pozicion i lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion i lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

iii) Një pozicion i lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

iv) Një pozicion i lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës penale.

Bashkëlidhur është paraqitur edhe projektvendimi përkatës.

Do të njoftohet zoti {...} për të drejtën e zgjedhjes së tij sipas pikës 1, e cila duhet të ushtrohet brenda tre ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Një kopje t'i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votim nëse s'kemi diskutime?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Nuk dëgjohet vota.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord, por mendoj që ndoshta ka nevojë që pika e parë të korrigjohet, jo për shkak të suprimimit të pozicionit, por për shkak të vendimit të Këshillit që e ka caktuar në Gjykatën e Tiranës (vendimit nr. 130, datë 30.03). S'ka suprimim aty. Vendimi i Këshillit që thotë: 1. Deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm [...]. 2. Transferimin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 3.

Në rast të konfirmimit, gjyqtari z. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.

Por s'ke suprimim. Nuk ka lidhje suprimimi.

(Diskutohet nga anëtarët e Këshillit çështja e hedhur për diskutim nga zonja Luli, duke diskutuar mbi riformulimin e titullit dhe ndryshimin e dispozitivit të projektvendimit. Merr fjalën zonja Luli.)

Fatmira Luli: Duke e konsideruar pikën e parë të aktit që shkak nuk është suprimimi, propozoj që pika e parë e aktit të hiqet dhe vendimi të jetë vetëm me pikën 2 (ajo të jetë pika 1) dhe titulli të korrigjohet, nga "fillimi i procedurës së transferimit" në "procedurën e marrjes së pëlqimit për transferim të zotit {...} në gjykatat e shkallës së parë në juridiksionin e përgjithshëm".

Naureda Llagami: Atëherë, pavarësisht se filluam procedurën e votimit, zonja Luli në fakt ngriti një propozim. Në radhë të parë dëshiroj t'ia jap fjalën njëherë relatorit nëse bie dakord me propozimin. Më pas, nëse jo, vazhdojmë procedurën që lamë të votimit. Ndryshe, nëse relatori bie dakord, e hedhim me gjithë propozimin e zonjës Fatmira.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Unë jam dakord me propozimin e bërë nga zonja Luli, me një modifikim nëse më lejohet (pra jemi dakord me atë lloj propozimi).

Unë propozoj aktualisht, pasi dëgjova edhe propozimin e zonjës Luli, që pika e parë e projektvendimit e cila thotë: "Fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit z. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", në mendimin tim të hiqet si pikë (nëse edhe ju jeni dakord) dhe së dyti, meqenëse kjo reflekton edhe tek titulli i projektvendimit, unë do të propozoja edhe modifikimin e bërë për titullin e projektvendimit, që të jetë: "Për

ushtrimin e së drejtës së zgjedhjes për transferim të zotit {...} (pjesa tjetër vazhdon) në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm".

Naureda Llagami: Atëherë, për sa kohë zoti Kurushi bie dakord me propozimin e bërë nga zonja Luli, atëherë unë propozoj edhe një herë hedhjen në votim të projekt–aktit, së pari me propozimet e bëra nga të dy kolegët, dhe më pas nëse nuk kalon ky projekt–akt, me variantin e parë që pati sjellë Komisioni. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt–aktin së bashku me propozimet për ta ndryshuar "Për ushtrimin e së drejtës së zgjedhjes për t'u transferuar z. {...} në gjykatat e shkallës së parë në juridiksion të përgjithshëm", konkretisht:

1. T'i kërkojë gjyqtarit z. {...}, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i) Një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

iii) Një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

iv) Një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës penale.

2. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 1 duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin përpara afatit të komandimit të znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk merr pjesë në këtë çështje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zonja Marçela Shehu***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin përpara afatit të komandimit të znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt–akti i radhës, që ka të bëjë me përfundimin para afatit të komandimit të zonjës {...}.

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Atëherë, relacioni i radhës ka për objekt “Mbi projektvendimin “Për përfundimin përpara afatit të komandimit të znj. {...}””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përfshirë edhe vendimin e tij nr. 315, datë 19.12.2019 “Për shpalljen e

kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit", me vendimin nr. 68, datë 06.02.2022 ka vendosur:

1. "Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon nga data 10.02.2020.

3. Përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short."

Me vendimin nr. 52, datë 08.02.2022, pasi shqyrtoi kërkesën e znj. {...}, protokolluar në Këshill, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vendosi:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dyvjeçar.

2.Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 10.02.2022.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."

Këshilli, në mbledhjen e datës 18 janar 2023, ka konstatuar se ka një përpjesëtim të zhdrejtë të rritjes së numrit të konflikteve gjyqësore dhe pakësim të konsiderueshëm të numrit të trupës gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke shkaktuar një rritje të ndjeshme dhe të papërballueshme të ngarkesës së trupës gjyqësore dhe duke cenuar funksionalitetin e kësaj gjykate.

Aktualisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjithsej 40 (dyzet) pozicione të lira, nga të cilat 18 (tetëmbëdhjetë) janë të përkohshme dhe 22 (njëzetë e dy) janë të përhershme, referuar edhe tabelave përkatëse përcjellë nga Zyra e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me qëllim që të stabilizohet dhe të parandalohet cenimi i mëtejshëm i funksionalitetit të kësaj gjykate duke përfshirë edhe efektet që rrjedhin nga aplikimi i Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vazhdimi i krijimit të vakancave të tjera të përkohshme

dhe të përhershme, Këshilli, ka marrë disa vendime me qëllim që të mund të përmirësojë funksionalitetin e gjykatës së shkallës së parë Tiranë, tashmë të cenuar.

Konkretisht, janë marrë këto masa: i) Shpallja e hapjes së procedurës së lëvizjes paralele për 10 pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim u ndërmor duke marrë në konsideratë ngarkesën e konsiderueshme të dhomës civile, në përputhje me nenin 43 e vijues të ligjit "Për statusin" dhe vendimin nr.320, datë 17.09.2020 "Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve"; si edhe ii) hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për 6 pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

I. Propozimi i Komisionit

Marrë shkas, nga konstatimi i faktit se: i) Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë, konsiderohet gjykatë në nevojë, dhe ii) znj. {...} aktualisht e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është e caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është e nevojshme vendimmarrja e Këshillit për zgjidhjen e situatës që lidhet me komandimin e kësaj magjistrateje në funksion të garantimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioni në rrethanat në të cilat ndodhet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vijim të hapave dhe mekanizmave për përmirësimin e funksionalitetit në këtë gjykatë, propozon: "Përfundimin para afatit të komandimit të znj. {...}".

Lidhur me përfundimin para afatit të komandimit, situata ligjore parashikohet nga neni 57, pika 2 i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili parashikon si vijon: "2. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli, pasi merr mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati, mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara".

Në rastin objekt shqyrtimi, nuk jemi përpara procedurës së përfundimit para afatit të komandimit sipas nenit 57, të ligjit 96/2016, por përpara rastit kur Këshilli, me iniciativën e tij, duke vlerësuar rastin e cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi është prishur në këtë rast një nga kushtet thelbësore të komandimit

sipas nenit 54/4 të ligjit 96/2016 “Për Statusin”, kusht i rivlerësuar në raport me rrethanat e reja të krijuara.

Zonja {...}, aktualisht është e angazhuar për shkak të detyrës pranë Komisionit të Disiplinës dhe detyrave të tjera të ngarkuara pranë Grupit Ndërinstitucional të Punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, dhe me qëllim dorëzimin e detyrave për shkak të këtyre përgjegjësive, Komisioni propozon që komandimi të përfundojë më datë 10.02.2023.

II. Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë parashikohet përfundimi para afatit të komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në pikën e dytë parashikohen efektet juridike të këtij vendimi, të cilat do të fillojnë më datë 10.02.2023.

Në vijim parashikohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në pikën tjetër parashikohet e drejta e ankimit, ku kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Nëse nuk kemi diskutim, kalojmë në miratimin/votimin e projekt–aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin para afatit të komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e "këshilltarit ligjor" në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Efektet fillojnë më datë 10.02.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 06.12.2022, 10.12.2022, 13.12.2022. 14.12.2022 (2 mbledhje), 20.12.2022, 22.12.2022, 28.12.2022, 29.12.2022, 05.01.2023, 11.01.2023.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)****
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk merr pjesë në këtë çështje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zonja Marçela Shehu***.

*Anëtarja ***zonja Fatmira Luli***, nuk ndodhet në sallën e mbledhjes në momentin e hedhjes në votim të këtij projektvendimi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

11. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 06.12.2022, 10.12.2022, 13.12.2022. 14.12.2022 (2 mbledhje), 20.12.2022, 22.12.2022, 28.12.2022, 29.12.2022, 05.01.2023, 11.01.2023.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Procesverbalet ju janë përcjellë nga administrata.

Atëherë, nëse keni ndonjë gjë?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Në këtë votim nuk është pjesëmarrëse zonja Shehu, gjithashtu edhe zonja Luli.

(Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projektvendimin "Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor", të datave 06.12.2022, 10.12.2022, 13.12.2022, 14.12.2022 (2 mbledhje), 20.12.2022, 22.12.2022, 28.12.2022, 29.12.2022, 05.01.2023, 11.01.2023.)

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.01.2023)

***Pika 12 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). [1]

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

[1] Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk merr pjesë në këtë çështje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zonja Marçela Shehu***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Alsma Shehu, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Vladimir Karaj, Birn.

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e fundit në rendin e ditës lidhet me caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionin e përgatitur "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".

Deri më datë 26.01.2023, pranë KLGJ-së, është regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtaret Rudina Palloj dhe Diamela Goxha dhe Elsa Ulliri. Kjo e fundit ka dhënë dorëheqjen, e cila i është pranuar nga kryetarja e gjykatës për shkak se ka qenë anëtare në trupin gjykues të të bashkëpandehurit Hekuran Marku. Kanë pengesa ligjore gjyqtarët Etleva Deda, Irena Gjoka dhe Erjon Bani pasi kanë kryer veprime paraprake për procedimin penal në ngarkim të të pandehurit Jovan Mema, Aleks Memaj etj.; Erion Çela, Atalanta Zeqiraj dhe Flojera Davidhi, kanë në gjykim të bashkëpandehurit Ilirjan Duçellari etj; Flora Hajredinaj, Elsa Ulliri dhe Petrit Çomo po gjykojnë të bashkëpandehurit Hekuran Marku etj.;

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Duke pasur parasysh informacionin e parashtruar nga gjykata në nevojë për qenien e procedimeve të lidhura, si dhe numrin aktual të gjyqtarëve që plotësojnë kërkesat sipas këtij akti nënligjor për t'u caktuar pranë gjykatës në nevojë për gjykimin e çështjeve të veçanta, propozohet që gjykatat nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtari për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhet me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar sa u parashtrua më sipër.

Bashkëngjitur është edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret për t'u përshirë në short.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, Esmeralda Xhili.

Me përfundimin e shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor